



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 51 prot.

Kamëz, me 11.04.2023

V E N D I M

Nr. 39 dt. 11.04 2023

PËR  
PËR SHPËRBLIMIN E SPORTISTËVE DHE TRAJNERËVE TË EKIBEVE TË  
SHKOLLAVE TË BASHKISË KAMËZ, FITUESE NË NIVEL QARKU NË DISIPLINAT  
VOLEJBOLL DHE BASKETBOLL (MESHKUJ DHE FEMRA), NË KUADËR TË  
PROJEKTIT "EKIPET SPORTIVE NË SHKOLLA"

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 11.04.2023, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.27, Datë 07.04.2023, në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 ' PER VETEQEVERISJEN VENDORE', Ligjit Nr.79/2017 "Për Sportin", i ndryshuar me Ligjin Nr.105/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.79/2017 "Për Sportin", Vendimit të Këshillit të Bashkisë Kamëz nr.163, datë 21.12.2022 "Për Miratimin e Buxhetit për vitet 2023, 2024, 2025" ; Këshilli Bashkiak Kamëz:

V E N D O S I :

- Të miratojë shpenzimet për shpërblimin e sportistëve dhe trajnerëve të ekipeve të shkollave të Bashkisë Kamëz, fituese në nivel Qarku në disiplinat volejboll dhe basketboll (meshkuj dhe femra), në kuadër të projektit "Ekipet Sportive në Shkolla" si më poshtë:
  - 6 ekipe fituese x 60,000 lekë për ekip = 360,000 lekë
  - 9 trajnerë x 9,000 lekë për trajner = 90,000 lekë
  - Vlera totale = 450,000 lekë
- Struktura buxhetore do të jetë: Gr.O, Kap.5, Prog.09120, Arti.606.
- Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

